



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 409/2 Prot

Tiranë, më 24.4.2025

V E N D I M
PARALAJMËRIMI

Nr.18, datë 24.4.2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN E BASHKISË FUSHË-
ARRËZ DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR RREGULLIMIN E
LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkia Fushë-Arrëz,

VËREJ SE:

Me urdhërin nr. 127, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Fushë-Arrëz”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave përkatëse të administrimit të shërbimit civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 948/1 Prot., datë 20.12.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz me shkresën nr. 948/2 prot., datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Fushë-Arrëz”*.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Fushë-Arrëz, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 409 prot., datë 25.03.2025, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, nuk ka dërguar asnjë observacion, brenda afatit të vendosur nga Komisioneri për paraqitjen e tyre. Në këto rrethana, në përfundim të procesit, është përgatitur Raporti përfundimtar i mbikëqyrjes dhe Vendimi Paralajmërues, akte që do ti dërgohen institucionit, në përmbajtjen e të cilave janë lënë detyra për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri e vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, duke analizuar në mënyrë të hollësishme skemën e strukturës dhe në përfundim ka lënë detyra konkrete në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të cilat janë bazuar në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr. 1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 02.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*.

Këto akte rregullative, kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, eficiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri në Udhëzimin e përmendur më sipër, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit

të Pozicioneve të Shërbimit Civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshkrimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete në lidhje me këtë proces.

Për këtë arsye Komisioneri ka lënë si detyrë finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se nga ana e institucionit, janë bërë përpjekje për të respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të cilat konsistojnë kryesisht në nisjen e tyre, nëpërmjet publikimit të pozicioneve të lira në AKPA, por ato nuk janë finalizuar dhe për më tepër, janë lejuar disa gabime procedurale, edhe pse janë kryer shumë pak veprime administrative, ndër të cilat:

a) në të gjitha shpalljet e publikuara, për nivelin egzekutiv, **nuk janë respektuar afatet e** parashikuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (*Kreu IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25*), data e shpalljes së këtyre pozicioneve është e njëjta datë, si për njoftimin mbi përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak për lëvizje paralele, ashtu edhe për njoftimin mbi verifikimin paraprak të dokumentacionit për pranim në shërbimin civil;

b) **munqon** fusha kryesore mbi të cilën do të realizohet konkurrimi si dhe publikimi **nuk është bërë për grup pozicionesh**, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta;

c) rezulton që nga ana e titullarit është ngritur një **organ që do të zhvillojë procesin e konkurrimit për gjitha pozicionet e shpallura**, pavarësisht nivelit të nëpunësisë civile, ç’ka vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit dhe të akteve nënligjore të tij, që e mbulojnë këtë aspekt;

Nga ana tjetër, gjatë mbikëqyrjes është vënë re se në planin vjetor të rekrutimeve, nuk janë pasqyruar a)nevojat për rekrutim të cilat janë krijuar gjatë vitit, si edhe b) nuk janë evidentuar si numër dhe nuk janë nominuar pozicionet konkrete të punës për nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, të cilat mund të plotësohen edhe me kandidatë të tjerë që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioneri vlerëson se, duhet të mbahet në vëmendje dhe të pasqyrohet qartë, në planin e rekrutimit numri i pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët, të mesëm si dhe të lartë drejtues, të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar **kufijtë ligjor numerik të lejuar**.

Një tjetër moment që duhet të tregohet kujdes nga ana e njësisë përgjegjëse është edhe administrimi i dosjes së personelit. Dosja e personelit për çdo nëpunës duhet të përditësohet me

dokumentin aktual të gjëndjes gjyqësore dhe gjëndjes shëndetësore (*raportin mjekësor*) si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar sipas nenit 17, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Ndërkohë, duhet të evidentojmë faktin se në subjektin e mbikëqyrur janë konstatuar **19** raste, të emërimeve në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil. Punonjësit në këtë rast, janë emëruar më një urdhër të titullarit të institucionit duke mos respektuar procedurën e konkurrimit për pranim në shërbimin civil apo edhe procedurën në rastet e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Në këtë rast, veprimi administrativ i kryer nga titullari i institucionit është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe duhet të konstatohet si i tillë nga organi që e ka nxjerrë.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë me korrektësi kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, ashtu si është evidentuar edhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.

2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.

3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin (**19** raste), në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:
- **Sidorela Katroshi**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 583, datë 01.12.2023, “*Emërim në punë të përkohshëm*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Diasporës, Migracionit, Çështjeve Sociale dhe Projekteve;

- **Vilson Prenga**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 151 , datë 25.05.2021, “Për ndryshim pozicioni”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Tatim-Taksave;
- **Dorela Gjoni**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 636 , datë 26.12.2023 “Emërim në punë i përkohshëm”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist auditi”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm;
- **Ditmir Pershpalaj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 455, datë 16.10.2023 “Për emërim në punë i përkohshëm”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist Finance”, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit, në njësinë administrative Iballë;
- **Pal Miceli**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 328, datë 16.08.2023, “Emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist Finance”, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit, në njësinë administrative Iballë;
- **Algerta Velaj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 562, datë 16.11.2022 “Emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist tatim taksash & Finance Njësia Blerim”, në Sektorin e Tatim-Taksave;
- **Altin Smajli**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 457, datë 16.10.2023 “Emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist tatim taksash & Finance Njësia Iballë”, në Sektorin e Tatim-Taksave;
- **Zojë Boçi**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 431, datë 10.10.2023 “Emërim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist tatim taksash & Finance Njësia Fierzë”, në Sektorin e Tatim-Taksave;
- **Jetmira Murataj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 393, datë 04.08.2022, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialiste në planifikimin e territorit”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve;
- **Ndue Lika**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 412, datë 02.10.2023, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialiste në planifikimin e territorit”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve;
- **Vera Meçi**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 396, datë 02.08.2024, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist i menaxhimit dhe administrim territori Njësia Qafë Mali”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve;
- **Gjelosh Gugaj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 107, datë 29.03.2023, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist Bujqësie dhe Kadastrë”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve;
- **Adelajda Ndoci**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 119, datë 07.03.2024, “Për emërim në punë”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialiste e AKU-së”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve;
- **Aldi Lepuri**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 108, datë 29.03.2023, “Për ndryshim pozicioni”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Specialist per Çeshtjet Juridike dhe Prokurimet Publike”, në Sektorin Juridik dhe i Prokurimeve;

- **Vitore Cara**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 111, datë 05.03.2023, “*Emërim i përkohshëm*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialist Arkive*”, në Sektorin Juridik dhe i Prokurimeve;
- **Marije Morinaj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 463, datë 17.10.2023, “*Emërim në punë i përkohshëm*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialiste për Migracionin dhe Diasporën*”, në Sektorin e Diasporës, Migracionit, Integrimit Evropian dhe Turizmit;
- **Elis Miria**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 54, datë 10.02.2022, “*Emërim të përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialist për Këndin e BE dhe Projektet*”, në Sektorin e Diasporës, Migracionit, Integrimit Evropian dhe Turizmit;
- **Altin Engjëlli**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 206, datë 27.05.2024, “*Emërim në punë*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialist Koordinim-Zhvillimi për Arsimin, Shëndetësinë, Kulturën, Artet dhe Sportet*”, në Sektorin e Diasporës, Migracionit, Integrimit Evropian dhe Turizmit;
- **Albina Prengaj**, emëruar me anë të Urdhërit nr. 559, datë 21.11.2023, “*Emërim i përkohshëm*”, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “*Specialist IT*”, në Sektorin e Diasporës, Migracionit, Integrimit Evropian dhe Turizmit.

Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimi në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

6. Të përsëritet procedura e konkurrimit, për plotësimin e pozicionit të punës “*Përgjegjës i burimeve njerëzore*”, ku aktualisht kryen detyrën punonjësja Fatjona Selimaj, nga momenti i shpalljes së pozicionit të lirë pranë AKPA-së, duke saktësuar procedurën që duhet të aplikohet në këtë rast, nëse është ajo e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë, me kandidatë brenda shërbimit civil, ose nga kandidatë të tjerë nga jashtë sistemit, që i plotësojnë kriteret, nëse vlerësohet nga titullari i institucionit, duke respektuar gjithmonë kufizimet ligjore të vendosura në këtë dispozitë të ligjit. Njësia përgjegjëse dhe titullari i institucionit, të marrin masa për realizimin e kësaj detyre, duke kryer veprimet ligjore me qëllim rregullimin e situatës.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, Prefekti i Qarkut Shkodër Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Fushë-Arrëz, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha